REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2019:127053
Datë: 07.05.2020
Numri i dokumentit: 00917123

C.nr.534/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN/ DEGA SUHAREKË, me gjyqtarin Selajdin Gallapeni, në qështjen kontestimore të paditëses: Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, Rr. Lidhja e Pejës, magjistralja Prishtinë-Fushë Kosovë, kundër të paditurit E. A. P. nga fshati D., K. Suharekës, më objekt kontesti "Rimbursim të dëmit material dhe jomtarial", në shumën prej 3436 euro (tremijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë), pas seancave gjyqësore, gjykata me datën 07.05.2020 vendosi dhe mori këtë:

A K T G J Y K I M (Për mosbindje)

APROVOHET në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë ashtu që:

I. **DETYROHET** i padituri E. A. P. nga fshati D., K. Suharekës , që paditëses t'ia paguaj në emër të "Rimburism të dëmit material dhe jomtarial", shumën prej 3436 euro (tremijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë), me kamat sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, që nga dita e ngritjes së padisë deri në pagesën e fundit.

II. **Obligohet** i padituri qe palës paditëse t'ia paguaj shpenzimet e procedurës, ku për shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm, shumën prej 500 euro (pesëqind), si dhe për taksat gjyqësore shumën prej 15 euro, të gjitha këto obligohet i padituri që ti paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 31 tetor 2017 pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit padi me objekt kontesti ""Rimburism të dëmit material dhe jomtarial", në shumën prej 3436 euro, si dhe ka kërkuar që i padituri të obligohet t'ia paguaj edhe me kamatën sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, që nga dita e ngritjes së padisë deri në pagesën e fundit.

Gjykata ka dërguar padinë me prova dhe aktvendimin për përgjigjen në padinë C.nr.534/17 me 14.02.2019, ku siç shihet në konstatimin e dorëzuesit të postës është konstatuar se pala, e ka refuzuar marrjen. Gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor për datë 17.04.2019; 21.05.2019; 18.06.2019; 02.09.2019 ku e ka ftuar të paditurin, por në të gjithë fletëkthesat është konstatuar se i njëjti gjendet në Gjermani dhe familja e ka refuzuar marrjen. Në seancën e datës 02.09.2019

2019:127054

përfaqësuesja e palës paditëse D. H. i ka propozuar gjykatës që të paditurit ti caktohet një përfaqësues i përkohshëm, ku gjykata e ka aprovuar kërkesën e palës paditëse.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga ana e gjykatës drejtuar Odës së Avokatëve të Kosovës, si përfaqësues të përkohshëm gjykata të paditurit ia ka caktuar av. Sh. S. nga Suhareka. Gjykata ka lëshuar aktvendim të veçantë për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, ku të njëjtin edhe e ka publikuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe i cili është publikuar më datë 02.10.2019.

Përfaqësuesi i përkohshëm ka parashtruar përgjigje në padi për të paditurin dhe ka marrë pjesë në tri seancat gjyqësore të datës 12.12.2019, në seancën e datës 23.12.2019 dhe seancën e datës 14.01.2020. Gjykata duke vepruar sipas propozimit të palës paditëse me aktvendimin procedural të datës 14.01.2020 e ka shfuqizuar aktvendimin procedural C.nr.534/17 të datës 05.09.2019 pasi që i padituri tani më ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e datës 14.01.2019, ku të njëjtit i janë dërguar ftesa, padia, aktvendimi për përgjigje në padi, mirëpo i njëjti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim, pra nuk ka parashtruar përgjigje në padi dhe mungesën nuk e ka arsyetuar për seancën e datës 14.01.2020.

Andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi konsideron se janë përmbushur në mënyrë kumulative kushtet ligjore të parapara sipas nenit 150, parag.1 pika a.), b.), dhe c.) të LPK-së, ku citojmë nenin150.1 të LPK-s se:

"***Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi".***

Gjykata në rastin konkret konsideron se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore sipas nenit 150.1 pika a; b dhe c të LPK-s.

Ndërsa ***themelësinë e kërkesëpadisë*** gjykata e bazoi në provat e referuara si në padi e të cilat i ka administruar me datë 20.02.2020 siç janë*: Fletëtransferi i pagesës nga ana e BKS pranë Bankës Ekonomike ne shumen prej 3436 euro; Urdhërtransferi me numër 179/14 i datës 30.01.2014; Ujdia jashtëgjyqësore e datës 29.01.2014; Vendimi i shkalles se pare BKS:FK-853/13 i datës 10.01.2014; Vendimi i shkalles se pare me numër te dosjes 853/13 me date 10.01.2014; Formulari për kompensimin e demit material i datës 10.01.2014; Vlerësimi mjekësor i datës 18.12.2013 nga censorët e kompanisë; Raporti i aksidentit i Policisë se Kosovës 2013-GR-05220804/2013; Provat mjekësore.*

Nga provat e administruara shihet se këtu i padituri nuk ka pasur mbulesë të sigurimit në kohën kur është shkaktuar aksidenti, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga Raporti i aksidentit i Policisë se Kosovës 2013-GR-...../2013. Kurse dëmin e pësuar nga personi i tretë nga aksidenti e ka kompensuar këtu pala paditëse, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar sipas provave të administruara Fletëtransferi i pagesës nga ana e BKS pranë Bankës Ekonomike ne shumen prej 3436 euro, Urdhërtransferi me numër .../14 i datës 30.01.2014.

Gjykata vlerëson se baza ligjore e kërkesëpadisë së paditësit bazohet sipas Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia Nr.04/L-018, konkretisht sipas nenit 18 parag.1 të tij, i cili parasheh që, citojmë*: "Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja".*

2019:127054

Ndërsa në rastin konkret shihet se i dëmtuari është kompensuar nga pala paditëse, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar sipas provave të administruara Fletëtransferi i pagesës nga ana e BKS pranë Bankës Ekonomike ne shumen prej 3436 euro, Urdhërtransferi me numër .../14 i datës 30.01.2014.

Gjykata përkundër asaj që për të padituri ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm av. Sh. S. nga Suhareka, i cili në emër të të padituri ka parashtruar përgjigje në padi, si dhe ka marrë pjesë në tri seanca gjyqësore, ku në seancën e datës 14.01.2020, gjykata me aktvendimin procedural e ka shfuqizuar aktvendimin me të cilin av. Sh. S. është caktuar si përfaqësues i përkohshëm. Ky vendim procedural është i bazuar konformë nenit 387 parag.2 , nenit 82.2 të ndërlidhur me nenin 110 parag 1 të LPK-s, pasi që siç shihet nga fletëkthesa e datës 31.12.2019 padinë, procesverbalin e datës 23.12.2019, si dhe aktvendimin për përgjigje në padi i ka pranuar personalisht i padituri, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në padi, si dhe nuk e ka prezantuar në seancën e datës 14.01.2020 ku i njëjti ka qenë i njoftuar nga procesverbali i dërguar i datës 23.12.2019.

Pra, gjykata e ka shfuqizuar aktvendimin për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, pasi që përfaqësuesi i përkohshëm në seancën e datës 23.12 2019 ka theksuar se të padituri e ka njoftuar me padinë në adresën si në padi, andaj gjykata ka vendosur që tani e tutje të komunikimi të bëhet me të padituri , ku i njëjti edhe i ka pranuar shkresat gjyqësore personalisht. Vlen të theksohet se këto shkresa iu kanë dërguar të padituri nga ana e përfaqësuesit të përkohshëm, përmes shkresës së datës 11.12.2019 dhe të cilën e ka pranuar personalisht i padituri me datë 16.12.2019.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale në shumën prej 30 euro gjykata iu referua pagesës së taksës, si dhe shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm në vlerë prej 500 euro (pesëqind) gjykata për këtë u bazua në kuptim të nenit 452 par. 1 të LPK-s.

Andaj, duke u nisur nga ato që theksuam si më lartë, kjo gjykatë dispozitivin e këtij aktgjykimi e mbështeti në kuptim të nenit 143 dhe nenit 150 par. 1 të LPK-së.

Me qka u tha më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr. 534/2017 Nr. Lëndës: 2019:127053 Dt. 07.05.2020

Gjyqtari
Selajdin Gallapeni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë brenda afatit ligjor prej 15 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, duke ju drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.

2019:127054